

Për:	Operatori Ekonomik: “Multi Business Group” Sh.p.k. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	10.03.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 10.03.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Multi Business Group” Sh.p.k. me adresë në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZGJERIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-19-6571-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-19-061-5-1-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Multi Business Group” Sh.p.k. me adresë në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZGJERIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-19-6571-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-19-061-5-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 05.03.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **ZGJERIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: 623-19-6571-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-19-061-5-1-1, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: “Multi Business Group” Sh.p.k. me adresë në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZGJERIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-19-6571-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-061-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 05.03.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net.>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 10.03.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, në cilin pretendon se janë shkelur këto nenet:

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 39 i RrUOPP-së – Sqarimi i Tenderëve

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari Nenin 60 paragrafi 1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se AK Komuna e Rahovecit ka vlerësuar ofertat në përputhje me LPP-në.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit